

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6569
E shtunë, 26 mars 2022
çmimi 0.40 €

Mediet austriake
shkruajnë për padrejtësitë
e Gjykatës Speciale | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


QYTETARËT SERBË KANË PROTESTUAR TË PREMTEN KUNDËR MOSMBAJTJES
SË ZGJEDHJEVE TË SERBISË NË KOSOVË | FAQE 4-5

SERBËT PEZULLOJNË PUNËN NË INSTITUCIONET E KOSOVËS



Kryetari i Listës Serbe, njëherësh ministër për Komunitete dhe Kthim, Goran Rakiq, i është bashkuar të premtën protestës së serbëve në veri, të cilët kanë dalë ta kundërshtojnë vendimin e Qeverisë së Kosovës për mosmbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në vendin tonë. Rakiq para medieve ka pohuar se serbët do ta pezullojnë punën derisa të rikthehet në punë kryetarja e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Liljana Stevanović

Kurti takohet me drejtuesit e OVLUÇK-së, bisedojnë edhe për pastrimin e listave të veteranëve | FAQE 5



AKADEMIK QOSJA: SALI BERISHA PO I TOLLOVIT SHQIPTARËT NË SHQIPËRI E KOSOVË | FAQE 3

AKTUALE



11 246 SHQIPTARË KËRKUAN AZIL VITIN E KALUAR F. 3

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E OKB-SË MIRATON REZOLUTË PËR MBROJTJEN E CIVILËVE NË UKRAINË F. 2

HARADINAJ: GAZPROMI RUS KA VDEKUR, HAPNI RRUGË GAZIT AMERIKAN F. 7

EKONOMI



KOSOVA, 130 AUDITORË TË CERTIFIKUAR NË NIVELE TË NDRYSHME F. 8

TURIZMI NË SHQIPËRI MBETET POSHTË NIVELEVE TË PARAPANDEMISË F. 8

SPORT



SUPERLIGA E BASKETBOLLIT SJELL DERBIN RAHOVECI - PEJA F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rusia thotë se mbi 1 300 ushtarë janë vrarë në Ukrainë

MOSKË, 25 MARS - Rusia ka thënë se 1 351 ushtarë rusë kanë vdekur në Ukrainë, thanë zyrtarë të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Ruse. Gjeneralkolonel Sergey Rudskoy tha se edhe 3 825 ushtarë janë plagosur që prej se Rusia nisi pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt.

NATO tha më herët gjatë javës se 7 000 deri në 15 000 ushtarë rusë mund të jenë vrarë në katër javët e para të luftës në Ukrainë. Në shifrat e paraqitura nga Rusia duket se nuk janë përfshirë edhe separatistët që luftojnë në lindje të Ukrainës - të cilët mbështeten nga Rusia - dhe nuk është e qartë nëse

në këtë shifër përfshihen edhe trupat e tjera ruse që nuk janë pjesë e Ministrisë së Mbrojtjes, siç janë pjesëtarët e Gardës Kombëtare. Ukraina gjatë kësaj jave ka thënë se mbi 15 000 ushtarë rusë janë vrarë gjatë luftimeve me forcat ukrainase.



Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miraton rezolutë për mbrojtjen e civilëve në Ukrainë




NJU-JORK, 25 MARS - Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka miratuar një rezolutë, e cila kërkon mbrojtjen e civilëve dhe infrastrukturës civile në Ukrainë, si dhe ndaljen e menjëhershme të luftës. Rezoluta, e cila është miratuar më 24 mars në selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork, ka siguruar 140 vota në të mirë të saj nga 193 në total. Katër shtete - Siria, Bjellorusia, Koreja Veriore dhe Eritrea - i janë bashkuar Rosisë me votë kundër dhe 38 shtete kanë abstenuar. Rezoluta "kërkon ndalje të menjëhershme të armiqësive nga Federata Ruse kundër Ukrainës, në veçanti për sulmet

kundër civilëve apo objekteve civile". Në të kërkohet edhe mbrojtja e civilëve, stafit mjekësor, punëtorëve për ndihma dhe gazetarëve. Sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Antonio Guterres, e ka konsideruar pushtim rus në Ukrainë si "luftë absurde", e cila ka lënë të vdekur mijëra njerëz, ka shkatërruar shtëpi, ndërtesa dhe ka krijuar miliona refugjatë. Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme nuk janë detyruese, mirëpo kanë peshë politike. Një rezolutë e ngjashme jodetyruese është miratuar edhe më 2 mars, në të cilën i kërkohet Rosisë që ta ndalë përdorimin e forcës.

Ajo rezolutë është miratuar me 141 vota. Ukraina dhe vendet aleate e kanë akuzuar Moskën se është duke shënjestruar civilët pa dallim dhe është duke shënjestruar objektet ku po strehohen njerëzit. Moska mohon diçka të tillë. Presidenti rus, Vladimir Putin, ka urdhëruar pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt. Ai ka urdhëruar "operacion special" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Veprimi i Kremlinit ka nxitur zemërim dhe është dënuar në shumë vende të botës. Shtetet e Bashkuara dhe aleatët janë përgjigjur me sanksione të ashpra kundër Moskës.

Bideni thotë se Putini e llogariti gabim vendosmërinë e Perëndimit



UASHINGTON, 25 MARS - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, ka thënë se presidenti rus, Vladimir Putin, e ka llogaritur gabim vendosmërinë perëndimore para se ta niste pushtimin e paprovokuar të Ukrainës. Sipas tij, presidenti rus nuk e ka menduar se shtetet perëndimore do të ishin të unifikuara për vendosjen e sanksioneve dhe mbështetjen me armë për forcat ukrainase. Biden u tha gazetarëve në një konferencë në Bruksel se pushtimi rus i Ukrainës ka ndërtuar unitet më të madh brenda NATO-s, Bashkimit

Evropian dhe grupit të shtatë vendeve më të industrializuara, G7. "NATO kurrë nuk ka qenë më e unifikuar se sot. Putini po merr pikërisht të kundërtën e asaj që synonte të merrte si pasojë e hyrjes në Ukrainë", ka thënë Biden pas një takimi me udhëheqësit e NATO-s. Putini "nuk mendoj se ne do të mund të mbanim këtë kohezion", ka deklaruar Biden. Shtetet e NATO-s dhe aleatët e tjerë kanë vendosur sanksione të ashpra ekonomike ndaj Rosisë. Deri më tani, megjithatë, BE-ja nuk ka shkuar aq larg sa ShBA-ja, e cila ka ndaluar importet e gazit

dhe naftës ruse. Biden, po ashtu, ka thënë se NATO do të përgjigjej nëse Rusia do të përdorte armë kimike në Ukrainë dhe ka shtuar se ai mendon se Rusia do të duhej të përjashtohet nga grupi G20. Ai ka thënë se kjo çështje është ngritur gjatë takimit me liderët botërorë në Bruksel. "Përgjigjja ime është po, por varet nga G20", ka thënë ai kur është pyetur nëse Rusia do të duhej të përjashtohet nga ky grup. Sipas presidentit Biden, NATO do të përgjigjej kundërt çdo përdorim të armëve kimike dhe natyra e përgjigjes do të varej "shumë nga natyra e përdorimit".

Ukraina dëbon diplomatë bjellorusë

KIEV, 25 MARS - Ministria e Jashtme e Ukrainës ka kërkuar nga Bjellorusia që të shkurtojë në pesë numrin e diplomatëve në ambasadën e saj në Kiev. Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme, Oleh Nikolenko, ka thënë se ky vendim ishte përgjigje ndaj një vendimi të ngjashëm të ndërmarrë nga Minsku një ditë më parë. Qeveria bjelloruse tha më 23 mars se do ta mbyllë Konsullatën e Përgjithshme

ukrainase që gjendet në Brest dhe urdhëroi një numër të paspecifikuar të diplomatëve ukrainas të largohen nga ambasada në Minsk, teksa Bjellorusia vazhdon t'i ndihmojë forcat e armatosura ruse në sulmet kundër Ukrainës. Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme bjelloruse, Anatol Hlaz, tha se ambasadori ukrainas dhe katër punëtorë të ambasadës do të lejohen të qëndrojnë në Bjellorusi, ndërsa pjesa e tjetër e

stafit do të detyrohet të largohet nga vendi. Ai tha se ky vendim është marrë për shkak të "veprimeve të shumta jomiqësore të Ukrainës" të kryera ndër vite "me qëllim që të prishen raportet ndërshtetërore" me Bjellorusinë. Bjellorusia e ka ndihmuar pushtimin e presidentit rus, Vladimir Putin, duke lejuar që trupat ruse ta shfrytëzojnë territorin bjellorus për të nisur sulme ndaj Ukrainës.



Akademik Qosja: Sali Berisha po i tollovit shqiptarët në Shqipëri dhe Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 MARS - Akademik Rexhep Qosja ka komentuar zhvillimet brenda Partisë Demokratike në Shqipëri. Ai ka thënë se Sali Berisha që gati një vit po i tollovit shqiptarët në Shqipëri e Kosovë. "Megjithëse në moshën kur moshanikët e tij (Sali Berishës) enden korridoreve të spitaleve me fashikuj në duar plot diagnoza e dokumente të tjera mjekësore, ai po i bën këto beteja politike dhe që gati një vit po i tollovit shqiptarët në Shqipëri e Kosovë, unë, pas qindra e qindra faqeve të shkruara kundër politikës së tij,


do të shkruaj tani një panegjirik për të: për energjitë e tij, për demagogjitë e tij artistike, për mendimet e tij të qarta, buçitëse, të sistemuara, të tejprerë të dëgjueshme. E di se me atë panegjirik nuk do ta shpëtoj prej veprimit kundër vetvetes, por unë do të përpiqem ta bëj të amshueshëm në historinë shqiptare përplot të papritura e fatkeqësi", ka shkruar Qosja në llogarinë e vet në "Facebook".

Sipas tij, Berisha e filloi dhe po e vazhdon betejën politike kundër sekretarit amerikan të Shtetit, Antoni Blinken, i cili, në emrin e SHBA-së, e shpalli person të padëshiruar në SHBA dhe po sillet e po vepron si të mos ishte i

shpallur i tillë. "Dhe, në këtë betejë angazhoi edhe avokat francez, edhe gkykatës francez! Edhe shtet tjetër! E filloi dhe po e vazhdon betejën politike kundër ambasadores amerikane në Tiranë, Juri Kim! Dhe, me këtë betejë politike kundër ambasadores amerikane, ai në të vërtetë po bën betejë politike kundër SHBA-së duke mos menduar aspak se SHBA me UÇK-në dhe me NATO-n jo vetëm ndalën gjenocidin që bënte Serbia e Millosheviqit duke dëbuar afro 1 milion shqiptarë prej Kosovës, por edhe e çliroi Kosovën prej okupimit shekullor serb duke e bërë çka është sot: shtet i lirë e i pavarur", ka thënë

Qosja, duke shtuar se Berisha e filloi dhe po e vazhdon betejën politike brenda Partisë Demokratike të Shqipërisë që ia mohoi veprimtarinë pasi u shpall person i padëshiruar në SHBA! "Dhe, e 'filloi' këtë betejë politike me puç partiak! E filloi dhe po e vazhdon betejën politike kundër krijesës së tij politike, birrit të tij politik, kryetarit të PDSH-së, Lulëzim Basha, të cilin më në fund e detyroi të japë dorëheqje nga posti i kryetarit të PDSH-së. E filloi dhe po e vazhdon betejën politike për t'u dëgjuar zëri dhe mendimi i tij si dikur! Dhe, po i dëgjohen! E filloi dhe po e vazhdon betejën politike kundër bashkëpartiakëve të

padëgjueshëm dhe krijoi parti të re të quajtur, çfarë çudie, kur Shtëpia e Lirisë, e kur foltozja! E filloi dhe po e vazhdon betejën politike, po bën çmos, s'po lë gur e dru pa lëvizur, për ta fituar atë betejë politike kundër kryeministrit të sotëm të Shqipërisë, Edi Rama, duke çuar në këmbë kundër tij të rinj e të moshuar, gra e burra, me pretekst ngritjen e çrimeve të shportës e të naftës megjithëse ai, Edi Rama, nuk ishte ngritësi i tyre! E filloi dhe po i vazhdon të gjitha këto beteja politike për Shqipërinë Autoritare në të cilën do të jetë çka ishte, shumë vite, dikur - sundues autoritar", ka thënë akademik Rexhep Qosja.



11 246 shqiptarë kërkuar azil vitin e kaluar

TIRANË, 25 MARS (ER) - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka thënë se shpopullimi në këtë vend nuk po ndalet. Ai ka thënë se vitin e kaluar, sipas "European Union Agency for Asylum", 11 246 shqiptarë kërkuar azil në një nga vendet e Bashkimit Evropian, duke e renditur Shqipërinë sërish të parën për numrin e aplikimeve. "Largimi i

të rinjve, si dhe i fuqisë intelektuale dhe punëtore më të kualifikuar, në mungesë të shpresës dhe perspektivës, është një problem kombëtar alarmues, që duhet të na bashkojë të gjithëve, duke adresuar me përgjegjshmëri, me atdhetari dhe me profesionalizëm. Ta ndalim shpopullimin duke përmirësuar

standardet e qeverisjes, të llogaridhënies demokratike dhe rritur përfaqësimin e të rinjve në vendimmarrje! T'i bashkojmë energjitë për ta rikthyer shpresën dhe për t'i dhënë Shqipërisë drejtimin dhe perspektivën e merituar evropiane, që të gjithë e dëshirojmë!", ka shkruar Meta në llogarinë e vet në "Facebook".





QYTETARËT SERBË KANË PROTESTUAR TË PREMTEN KUNDËR MOSMBAJTJES SË ZGJEDHJEVE TË SERBISË NË KOSOVË

Serbët pezullojnë punën në institucionet e Kosovës

Kryetari i Listës Serbe, njëherësh ministër për Komunitete dhe Kthim, Goran Rakiq, i është bashkuar të premtën protestës së serbëve në veri, të cilët kanë dalë ta kundërshtojnë vendimin e Qeverisë së Kosovës për mosmbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në vendin tonë. Rakiq para medieve ka pohuar se serbët do ta pezullojnë punën derisa të rikthehet në punë kryetarja e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Liljana Stevanović

“Epoka e re”

PRISHTINË, 25 MARS - Kryetari i Listës Serbe, njëherësh ministër për Komunitete dhe Kthim, Goran Rakiq, ka thënë të premtën se serbët do ta pezullojnë punën në institucionet e Kosovës derisa të kthehet në detyrë Liljana Stevanović, kryetare e Gjykatës Themelore të Mitrovicës, e suspenduar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për pjesëmarrje në një takim me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Gjatë protestës së serbëve në Mitrovicë të Veriut të premtën nuk ka pasur fjalime, ndërsa njoftimin për pezullimin e punës në institucionet e Kosovës Rakiq e ka konfirmuar për mediet pas protestës. “I dërgoj një mesazh Albin Kurtit, Policisë së Kosovës, se nuk do të na frikësoni. Nuk kërkojmë asgjë më shumë sesa që kanë shqiptarët në Kosovë. Duam paqe. Dua të theksoj se për herë të parë nuk kemi arritur një marrëveshje me presidentin Aleksandër Vuçiq për t’u larguar nga institucionet e Kosovës. Edhe sot i kemi kërkuar të njëjtën gjë, por ai ka kërkuar që mos ta

bëjmë. Dua të theksoj se të gjithë serbët që punojnë në institucionet e Kosovës, duke përfshirë policinë, do ta pezullojnë punën deri në kthimin e Liljana Stevanovićit”, ka thënë ai. Ndërkohë nënkryetari i Listës Serbe, njëherësh kryetar i komunës së Shtërpçës, Dalibor Jevtiq, ka thënë në Graçanicë se mesazhi kryesor i protestës ishte “të ndalet dhuna institucionale ndaj serbëve”. Serbët e Kosovës kanë protestuar në Mitrovicë të Veriut dhe në Graçanicë afër Prishtinës, kundër vendimit të Qeverisë së Kosovës për të mos lejuar mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale serbe në Kosovë më 3 prill. Protestuesit mbanin parulla “Me paqe kundër dhunës së Kurtit”, “Kurti nuk do t’i dëbojë serbët nga Kosova dhe Metohia”, “Duam vetëm të drejtat tona”. Popullata e katër komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës ka protestuar në Mitrovicë e Veriut, ndërsa ata që jetojnë në gjashtë komunat me shumicë serbe në jug të lbrit kishin arritur në mënyrë të organizuar në Graçanicë.

Protestat në veri të Mitrovicës dhe në Graçanicë kanë kaluar qetë dhe pa incidente. Shefat e misioneve të Francës, të Gjermanisë, të Italisë, të Mbretërisë së Bashkuar, të Shteteve të Bashkuara dhe të Bashkimit Evropian në Kosovë kishin shprehur shqetësime për rrezikun e përshkallëzimit apo dhunës në protestat e së premtës. Vendet e Quint-it dhe të BE-së, po ashtu, kanë përsëritur thirrjet e tyre ndaj Kosovës dhe Serbisë që të përmbahen nga secila retorikë apo vendim, që mund të çojë në rritje të tensioneve. Prishtina zyrtare pretendon se zgjedhjet serbe në Kosovë nuk ishin të ndaluara, porse nuk u arrit marrëveshje ndërmjet dy palëve për mbajtjen e tyre. Kryeministri Albin Kurti këmbënguli që Beogradi zyrtar t’i dërgojë një kërkesë të drejtpërdrejtë Qeverisë së Kosovës për mbajtjen e zgjedhjeve, gjë të cilën Serbia e vlerësoi si presion për njohjen e Kosovës dhe refuzoi ta bëjë këtë. Shtetet e Quint-it kritikuan ashpër Qeverinë e Kosovës për moslejimin e mbajtjes së zgjedhjeve. Quint-i ka deklaruar se e vlerësoi qasjen e Serbisë në

gjetjen e zgjidhjes, por se Kosova ka refuzuar një propozim konstruktiv nga shtetet e Quint-it për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Propozimi i Quint-it ishte që zyrtarët ndërlidhës të Kosovës dhe të Serbisë të përdoren si kanali i vetëm zyrtar i komunikimit ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Serbisë për t’i përcjellë kërkesat e Serbisë tek autoritetet e Kosovës. Lidhur me dështimin e mbajtjes së zgjedhjeve në Kosovë, presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, u takua me përfaqësuesit

serbë të Kosovës në Beograd më 22 mars. Në takim morën pjesë edhe gjyqtarë dhe zyrtarë policorë serbë që punojnë në institucionet e Kosovës. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka suspenduar të enjten kryetaren e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Liljana Stevanović, për pjesëmarrje në atë tubim, deri në vendimin përfundimtar të komisionit disiplinor. Zyrtarët e Kosovës thanë se pjesëmarrja e saj në tubim minon integritetin dhe profesionalizmin e gjyqtarës.

KURTI REAGON PAS PROTESTËS NË VERI: UNË NUK I PEZULLOJ GJYQTARËT, NDOSHTA VUÇIQI E BËN KËTË NË SERBI

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka reaguar pas protestës në veri, kundër shkarkimit të kryetares së Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Liljana Stevanović, e cila kishte marrë pjesë në mbledhjen e sigurisë të thirrur nga presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Me këtë rast, Kurti ka thënë se nuk vendos për pezullimin e gjyqtarëve e as të prokurorëve siç mund të bëjë Vuçiqi. “Unë nuk jam as kryetar

dhe as anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK). Gjyqësori është i pavarur nga qeveria. Ndoshta në Serbi presidenti pezullon dhe largon gjyqtarët dhe prokurorët. Ky nuk është rasti në Kosovë ose me gjyqtaren Stevanović. Ne jemi vendi më demokratik në Ballkanin Perëndimor, plotësisht në linjë me BE-në dhe NATO-n”, ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në “Twitter”.

Mediet austriake shkruajnë për padrejtësitë e Gjykatës Speciale

Prishtinë, 25 mars - Agjencia e lajmeve austriake APA botuar një shkrim të gjatë për padrejtësitë e Prokurorisë së Gjykatës Speciale, e cila po ua bënë ish-krerëve të UÇK-së të cilët tash e 16 muaj mbahen në Hagë.

Shkrimin e APA-s e ka marrë edhe gazeta prestigjioze austriake "Die Presse", me titullin "Avokatët e ish-presidentit të Kosovës kritikojnë Gjykatën e Krimeve të Luftës". "Dokumentet e nxjerra" dhe informacionet e pasakta e vështirësuan mbrojtjen e Hashim Thaçit, kritikojnë avokatët e të akuzuarit, i cili prej vitit 2020 e ka pritur gjykimin dhe prej atëherë është në paraburgim. Dy avokatët e të akuzuarit, ish-komandantit të

UÇK-së "Ushtrisë Çlirimtare" dhe më pas kryeministër dhe president i Kosovës, Hashim Thaçi, kanë kritikuar ashpër Gjykatën Speciale të Hagës për Krimet e Luftës në Kosovë.

Gregory Kehoe dhe Dastid Pallaska u ankuan për bazën e lëkundur ligjore dhe mungesën e mekanizmave të kontrollit për gjykatën sa i përket gjykatës, shkruan agjencia e lajmeve austriake APA. Sipas kësaj agjencie, gjykata e OKB-së për krimet e luftës në ish-Jugosllavi (ICTY) u krijua në bazë të një rezolute të OKB-së, Gjykata Speciale për Kosovën bazohet në Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet kombëtare të Kosovës. Krahasuar me ICTY (1993-2017),

ku ai punoi në rastin e ish-gjeneralit kroat Ante Gotovina, ka "dallime të theksuara", thotë Kehoe.

Gjyqtarët dhe prokurorët e ICTY raportuan në OKB dhe kontrolloheshin nga OKB-ja. "Fatqësisht, në rastin tonë nuk ka mekanizma kontrolli (...) Kjo mungon plotësisht në rastin tonë. Prandaj, nuk ka asnjë përgjegjësi për aktivitetet e zyrës së prokurorit publik". Të vetmet mekanizma të mundshëm kontrollues (korrektues) janë media dhe shoqëria e Kosovës.

Mbi të gjitha, për Kehoe është gjithashtu një therrë në sy që të akuzuarit nuk mund të mbrohen para Gjykatës Speciale në liri, "siç

ishte e mundur lehtësisht me ICTY", por që të gjithë janë në paraburgim. Për shembull, ish-komandantët e UÇK-së, Fatmir Limaj dhe Ramush Haradinaj, u liruan si të dyshuar të ICTY-së. Limaj, më vonë ministër nën kryeministrin Thaçi, dhe Haradinaj, kryeministër i pasluftës, u liruan nga ICTY për krime lufte. Është të paktën "çuditëse" që ish-presidenti Thaçi, nga ana tjetër, nuk ka mundësi ta presë vendimin në liri për rastin e Gjykatës Speciale të Kosovës, edhe pse është treguar shumë bashkëpunues, shkruan agjencia e lajmeve austriake APA. Kolegu i Kehoes, Pallaska, u ankua në intervistën dhënë APA-s se ishin shkelur afatet edhe për Gjykatën

Speciale: "Gjykata u krijua më 3 gusht 2015 me një mandat pesëvjeçar dhe duhej të përfundonte në gusht 2020, gjë që nuk ka ndodhur. Veçanërisht pasi jemi në vitin 2022, është e evidente se gjykata ka pothuajse dy vjet që funksionon pa bazë ligjore, edhe nëse prokuroria ka mendim të ndryshëm për këtë. Kushtetuta e Kosovës parasheh (...) që mandati të përfundojë pas pesë vjetësh", tha avokati.

Avokatët kritikojnë edhe numrin prej 326 dëshmitarësh të prokurorisë, për dëshmitë e të cilëve janë planifikuar rreth 1 930 orë. Nëse merret parasysh se edhe mbrojtja ka dëshmitarët e saj, gjykimi pritet të zgjasë disa vjet.



Kurti takohet me drejtuesit e OVLUÇK-së, bisedojnë edhe për pastrimin e listave të veteranëve



PRISHTINË, 25 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur të premten në takim ushtruesin e detyrës të kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Faton Klinaku, së bashku me kryetarët e disa degëve të kësaj organizate.

Ky takim vjen në kohën kur kryeministri Kurti ka deklaruar se nuk janë 60 mijë veteranë të UÇK-së, por rreth 20 mijë. Në këtë takim kryeministri Kurti ka theksuar përkushtimin e qeverisë për

thellimin e bashkëpunimit me OVLUÇK-në, me qëllim të përmirësimit të mirëqenies së veteranëve të luftës.

Kurti ka shprehur gatishtësinë për takime të radhës që do t'i kontribuonin këtij qëllimi. Ndërsa përfaqësuesit nga OVLUÇK-ja kanë paraqitur kërkesat dhe shqetësimet e tyre lidhur me mirëqenien e veteranëve dhe mundësitë e shtimit të bashkëpunimit për ta përmirësuar gjendjen e tyre.

Po në këtë takim është diskutuar

edhe çështja e pastrimit të listave, për çfarë përfaqësuesit e OVLUÇK-së janë shprehur të gatshëm për t'i gjetur mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen me Qeverinë e Kosovës.

Gjatë takimit, ku ishte i pranishëm edhe Aziz Bici, këshilltar i kryeministrit për çështje të kategorive të dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), është biseduar edhe për tema të tjera të rëndësishme lidhur me statusin dhe gjendjen e veteranëve të luftës çlirimtare.

Mirënjohje për veteranët e KFOR-it danez

MITROVICË, 25 MARS (ER) - Nën kryetari i komunës së Mitrovicës, Arian Tahiri, së bashku me drejtoreshën e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Valdete Idrizi, kanë mirëpritur të premtën në takim veteranët e KFOR-it danez të cilët kanë shërbyer në Kosovë, e shumë prej tyre edhe në Mitrovicë në periudha të

ndryshme kohore. Gjatë këtij takimi është bërë dhënia e mirënjohjeve si shenjë falënderimi për kontributin e tyre të dhënë për ndërtimin e paqes dhe të sigurisë në vendin tonë. Këto mirënjohje ua dha nënkryetari Tahiri, i cili është shprehur tejet falënderues ndaj ushtarëve të KFOR-it danez, që

falë pranisë dhe misionit të tyre paqeruajtës u bënë faktorë të rëndësishëm për lirinë e vendit tonë.

Një nga përfaqësuesit e KFOR-it danez tha se ndihet i privilegjuar që ka shërbyer për Kosovën, e sidomos për Mitrovicën dhe se është krenar për përparimin dhe të arriturat e shtetit të Kosovës.



Në 23-vjetorin e rënies përkujtohet dëshmori Beqir Meha

SKENDERAJ, 25 MARS (ER) - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, bashkë me nënkryetarin Sami Lushtaku, familjarët, përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, drejtorët komunalë, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët, kanë përkujtuar sakrificën heroike të njërit ndër luftëtarët e parë çlirimtar, Beqir Meha - vëllait të Tahir Mehës. "23 vjet më parë Beqir Meha ra në emër të lirisë së Kosovës. Lavdi jetës dhe rënies së tij! Lavdi të gjithë dëshmorëve të lirisë!", ka thënë kryetari Nura.

Kryetari i Gjilanit falënderon KFOR-in për kontributin e dhënë për sigurimin e paqes

GJILAN, 25 MARS (ER) - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, së bashku me nënkryetaren Leonora Morina-Bunjaku, kanë pritur në takim zëvendëskomandantin e Komandës Rajonale Lindje, lejtant Eddy Simpson dhe përfaqësues të KFOR-it. Në këtë takim me karakter njoftues, përveç sigurisë dhe zhvillimeve të përgjithshme në komunën e Gjilanit, është diskutuar rreth planeve dhe të arritave në arsim, shëndetësi, ekonomi dhe në fusha të tjera. "Në emër të qytetarëve i falënderova për kontributin e



vazhdueshëm të KFOR-it në sigurimin e paqes dhe stabilitet në vendin tonë, i cili është një parakusht për prosperitet. Ata

shprehën gatishmërinë për bashkëpunim dhe komunikim të mëtutjeshëm", ka thënë Alban Hyseni.



Rama e Mehaj nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi

PRISHTINË, 25 MARS (ER) - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, dhe ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit, qëllimi i së cilës është ofrimi i mbështetjes nga Ministria e Mbrojtjes përmes njësisë të FSK-

së për realizimin e aktiviteteve për mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së qytetarëve që mund të cenohen dhe rrezikohen nga prania e asbestit në zonën urbane, sidomos afër shkollave dhe në lagjet e urbanizuara të Prishtinës.

Të dielën në Podujevë mbahet aktiviteti 'Me biçikletë nis pranvera'



PODUJEVË, 25 MARS (ER) - Të dielën në Podujevë mbahet aktiviteti "Me biçikletë nis pranvera". Sipas njoftimit të kësaj komune, nisja bëhet nga sheshi "Ali Ajeti" në orën 12:00, në drejtim të fshatrave Letanc, Bajçinë, Peran, Obrançë.

Distanca që parashihet të marshohet me biçikleta është 17 kilometra, vlen të theksohet se terreni është i lehtë. "Ky aktivitet organizohet nga 'Llapi Bike Team' dhe 'Marakli t' Biciklave' me përkrahje nga komuna e Podujevës, aktiviteti nuk ka

karakter garues, por rekreativ. Për shkak të sigurisë së përgjithshme në komunikacion, mosha e lejuar për pjesëmarrje në aktivitet është +15, ndërsa moshat më të reja vetëm nën përkujdesjen e prindit apo kujdestarit", ka njoftuar komuna e Podujevës.

Haradinaj: Gazpromi rus ka vdekur, hapni rrugë gazit amerikan

PRISHTINË, 25 MARS (ER) - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka theksuar se Gazpromi rus ka vdekur dhe duhet hapur rruga gazit amerikan. Ai ka thënë se BE-ja, megjithëse me vonesë, e paska nënshkruar

marrëveshjen e madhe për gazin e lëngshëm amerikan, projekt ky që e shkëputë Evropën nga varësia e gazit rus. "Për fat të keq, Qeveria e Kosovës, pa asnjë arsye të qëndrueshme, e kishte refuzuar gazin e lëngshëm amerikan, edhe pse gazsjellësi

do të ndërtohej me paratë e taksapaguesve amerikan. Për më keq edhe presidentja e vendit nuk ka pasur kurajën ta thotë qoftë edhe një fjalë të vetme, për një projekt ekonomik e të sigurisë për Kosovën e rajonin, të miratuar nga vetë presidenti Biden.

Tash që kanë ndryshuar konceptet e të gjithë botës demokratike për Rusinë dhe gazin rus, shpresoj t'i ndryshojnë edhe konceptet e kryeministrit e të presidentes të Kosovës dhe të ndryshojnë qëndrim dhe urgjentisht e pa asnjë vonesë t'i hapin rrugë



projektit të gazsjellësit Shkup - Prishtinë. Gazpromi rus ka vdekur, prandaj mos e vajtoni më!", ka shkruar Haradinaj.

Krusha e Madhe, Krusha e Vogël dhe fshatrat përreth janë dëshmi për çmimin e lirisë

EPOKA
ERE


Qendresa RAMA

RAHOVEC, 25 MARS - Ndërmjet 25 dhe 27 marsit të vitit 1999, në Krushë të Rahovecit si dhe në fshatra të tjerë përreth u vranë qindra persona të pafajshëm dhe u dogjën shumica e shtëpive. Tri ditët e tmerrit janë dëshmi e egërsisë së pushtetit gjenocidal të Serbisë, i cili nuk zgjodhi mjete kundër banorëve të këtyre fshatrave.

Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka thënë se Krusha e Madhe, Krusha e Vogël dhe fshatrat përreth janë dëshmi për çmimin e lirisë dhe sakrificën për të. "Këto vende ngjallin dhimbje, pikëllim dhe krenari. 23 vjet pas krimit, gratë e Krushës janë shndërruar në inspirim dhe në model të ngadhënjimit ndaj të keqes. Krusha dhe i gjithë shteti i Kosovës do të jetojnë përherë me kujtimin për të gjithë ata që ranë për liri. Nuk do t'i harrojmë ata,

por njësoj sikurse gratë e Krushës do të shikojmë kah e ardhmja dhe nuk do të ndalemi së kërkuari drejtësi", ka thënë Osmani, duke shtuar se secila nga këto ditë deri në mes të qershorit është e mbushur me dhimbje e krenari për popullin e Kosovës.

"Dje përkujtuam edhe të rënët në masakrën në Kotlinë të Kaçanikut, veprimtarët Latif Berisha e Agim Hajrizi (me familjarë) që u ekzekutuan më 24 mars në Mitrovicë si dhe avokatin e humanistin Bajram Kelmendi, i cili u ekzekutua mizorisht së bashku me dy djemtë e tij. Nesër bëhen 23 vjet nga masakra e tmerrshme ndaj familjes Berisha në Suharekë, ku pushteti i atëhershëm serb dëshmoi qëllimin e vet shfarosës duke vranë në mënyrën më brutale fëmijë, gra e të moshuar. Të gjithë të rënët janë kujtimi ynë i përhershëm, por edhe forca dhe vullneti për të ecur përpara!", ka thënë presidentja Osmani.



23 vjet më parë 46 njerëz u vranë mizorisht në Tërrnje

Kryetari i komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka përkujtuar të rënët e fshatit Tërrnje. Ai ka thënë se 23 vjet më parë 46 njerëz u vranë mizorisht në këtë fshatë. Muharremaj ka theksuar se kjo është e vërteta që e bëri Serbia në Kosovë. "U vra fëmija 18 muajsh Altion Bytyqi. U vra edhe e moshuara 83-vjeçare Ziza Vranovci. Shumë të tjerë prej tyre në moshë të ndryshme, të pafajshëm u vranë, pa faj. Kjo është e vërteta që e bëri Serbia në Kosovë. Familjarët e tyre edhe pas shumë viteve kanë dhimbje e pikëllim. Ata kërkojnë vetëm drejtësi", ka thënë Muharremaj.

Osmani udhëton për në Katar


PRISHTINË, 25 MARS (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, me ftesë të emirit Sheikh Tamim bin Hamad Al Thani ka udhëtuar për një vizitë zyrtare në Shtetin e Katarit, ku do të pritë në takime nga zyrtarë të lartë të shtetit, si dhe do të marrë pjesë

në Forumin e Dohas, krahas udhëheqësve e përfaqësuesve të vendeve të tjera të botës. Në Forumin e Dohas presidentja Osmani do të flasë para pjesëmarrësve si një ndër folëset kryesore, ndërkohë që do të zhvillojë takime me përfaqësues të shteteve të tjera.

Gjatë vizitës në Katar Osmani do t'i bashkohet edhe zëvendëskryeministria, njëherësh ministre e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla-Schwarz.

Nën sloganin "Transformimi për një epokë të re", forumi i Dohas do të fokusohet në katër

tema kyçe: aleancat gjeopolitike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, sistemi financiar dhe zhvillimi ekonomik, mbrojtja kibernetike dhe siguria ushqimore, si dhe ndryshimet klimatike dhe qëndrueshmëria.



Kosova me 130 auditorë të certifikuar në nivele të ndryshme

PRISHTINË, 25 MARS (ER) - Kosova ka më shumë se 130 auditorë të certifikuar në nivele të ndryshme, ku rreth 90 prej tyre kanë arritur nivelin më të lartë si auditorë të certifikuar, ka bërë me dije auditorja e përgjithshme e Kosovës, Vlora Spanca, me rastin e 20-vjetorit të themelimit të Shoqatës së Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK).

Ajo ka përgëzuar drejtuesit e ShKÇAK-së për punën e deritanishme, duke thënë se themelimi i kësaj shoqate ka vendosur bazën për zhvillimin profesional të kontabilistëve dhe auditorëve të Kosovës, të cilët më pas i kanë shërbyer vendit në menaxhimin e financave si në sektorin privat dhe në atë publik.

Spanca ka folur për bashkëpunimin e vazhdueshëm në mes të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe ShKÇAK-së, i cili daton që nga viti 2004 përmes marrëveshjes së parë të

bashkëpunimit të ndërsjellët me qëllim të ngritjes profesionale të stafit dhe avancimit të ZKA-së. "Të qenit një Institucion Suprem i Auditimit (ISA) nënkupton aplikimin e standardeve profesionale, kryerjen e punës së auditimit sipas standardeve të zbatueshme dhe krijimin e një kuadri të përshtatshëm për të ofruar siguri të pavarur për cilësinë e punës së kryer. Andaj, zhvillimi profesional i auditorëve është thelbësor për punën e ISA-ve. Standardet ndërkombëtare theksojnë që roli i ISA-ve është një faktor i rëndësishëm për ta bërë ndryshimin në jetën e qytetarëve", ka deklaruar Spanca.

Me qëllim të ruajtjes së njohurive dhe kompetencës në punë, auditorët e ZKA-së në baza vjetore ndjekin programet për zhvillimin e vazhdueshëm profesional që ofrohen nga ShKÇAK-ja si dhe trajnimet e brendshme të vet institucionit.



Turizmi në Shqipëri mbetet poshtë niveleve të para pandemisë



PRISHTINË, 25 MARS - Numri i turistëve që kanë vizituar Shqipërinë nuk ka arritur t'i kapë ende nivelet e para pandemisë në dy muajt e parë të vitit, i ndikuar kryesisht nga rënia e hyrjeve nga Kosova.

Sipas të dhënave të Instat-it për periudhën janar - shkurt, 395 mijë shtetas të huaj kanë hyrë në Shqipëri, me një rritje prej 15-përqindësh në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kur vendi kishte lehtësuar kufizimet e pandemisë.

Por në krahasim me 2 muajorin 2019, që deri tani ka qenë viti më i mirë i turizmit, hyrjet janë 5 për qind më të ulëta.

Të dhënat zbulojnë që shtetasit nga Kosova, të cilët mbajnë peshën kryesore të turizmit në periudhën e pandemisë, kanë vijuar të jenë me rënie edhe në shkurt.

Hyrjet nga Kosova në dy muajt e parë të vitit ishin 21 për qind më

të ulëta se në janar - shkurt 2021 dhe pothuajse në të njëjtin nivel me periudhën e para pandemisë.

Vendosja e kriterit për vaksinë dhe test molekular nga Qeveria e Kosovës në muajt e parë të vitit ndikoi dhe në frenimin e hyrjeve nga Kosova në Shqipëri, duke dhënë efekt negativ të turizmit.

Rënia e turistëve nga Kosova është kompensuar nga hyrjet e shtuara nga Greqia (me një rritje prej 332-përqindësh) dhe Italia (ritje me 123 për qind).

Hyrjet nga Italia ishin 20 për qind më të larta edhe në raport me periudhën e parapandemisë, ndërsa nga Greqia mbeten 34 për qind më të ulëta.

Hyrjet e shtetasve nga Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, që zënë përkatësisht vendin e dytë dhe të tretë pas Kosovës, ishin pothuajse në të njëjtat nivele të një viti më parë.

Fillon zbatimi i masës 1.6 për mbështetjen e personave me nevoja të veçanta

PRISHTINË, 25 MARS (ER) - Në kuadër të vitit të personave me nevoja të veçanta siç është shpallur nga kryeministri i vendit, ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka marrë vendim për fillimin e zbatimit të masës 1.6 - Mbështetja e personave me nevoja të veçanta, në kuadër të Pakos së

Ringjalljes Ekonomike. Përmes kësaj mase Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve do të ofrojë mundësinë që personat me nevoja të veçanta të ndjekin trajnime për zhvillimin e mëtutjeshëm të shkathësive të tyre. Pra, në mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes trajnimit në punë (on the job training)

mundësohet që të trajnuarit të kenë mundësi më të mira punësimiti.

Gjithashtu, kjo masë pritet të shërbejë si nxitje për punësimin e qëndrueshëm, pasi që pas trajnimit MFPT-ja vazhdon të ofrojë mbështetje financiare për të trajnuarit që fillojnë marrëdhënie të rregullt pune me bizneset ku i kanë ndjekur

trajnimet.

Masa implementohet në bashkëpunim me OJQ-të të cilat do ta bëjnë përshtatjen e të trajnuarve dhe biznesit ku zhvillohet trajnimi. Sipas masës 1.6, mbështetja financiare përgjatë kohës së trajnimeve, që përbën një fazë tri deri në gjashtë muaj. Të trajnuarit përfitojnë 170 euro në muaj,

ndërsa bizneset përfitojnë nga 100 euro në muaj për person. Pas fazës trajnuese, biznesi dhe i trajnuari mund të lidhin marrëdhënie të rregullt pune, e cila, po ashtu, do të subvencionohet nga shteti, ku për punësim mbështetja do të jetë 270 euro në muaj për punëtor, për gjashtë muajt pasues.

Historia e jashtëzakonshme e Tomas Edisonit

PROBLEMET E MËDHA ME DËGJIMIN, NUK E PENGUAN TË BËHEJ NJË SHPIKËS I MADH

Tomas Alva Edison, ishte një shpikës unik, dhe ndikimi i tij mund të ndihet ende sot në jetën tuaj të përditshme. I lindur në Ohajo të SHBA-së më 11 shkurt 1847, shpikjet e Edisonit, ku përfshihet edhe përsosja e llambës elektrike dhe gramafonit, e transformuan rrënjësisht qytetërimin modern, dhe ndihmuan që shekulli XX-të të bëhej një nga epokat teknologjikisht më progresive në historinë e njerëzimit.

Përveç llambës elektrike, ishte autor i shumë shpikjeve të tjera

Ndërsa kontributi më i qëndrueshëm i Edisonit në jetën moderne, do të mbetet përgjithmonë llamba inkandeshente, ai mori gjithsej 1093 patenta për shpikjet që realizoi së bashku me stafin e tij. Disa nga shpikjet e Edisonit përfshinin: fonografin, makinerinë e parë që mund të kapte dhe riprodhonte zërin; stilolapsin me shabllon, një instrument shkrimi i fuqizuar nga energjia elektrike; transmetuesin prej karboni, që përmirësoi volumin dhe qartësinë e zërave në telefon. Po ashtu, ai gjithashtu ndihmoi në përmirësimin e shpikjeve ekzistuese, si treguesi i aksioneve dhe telegrafi automatik.

Pati shumë fëmijë, të cilët i edukoi me të gjitha mënyrat me dashurinë për dijen

Në dy martesat e tij, e para me Meri Stilluell nga viti 1871 dhe deri në vdekjen e saj në vitin 1884, dhe e dyta me Mina Miller në vitin 1886, Edisoni pati 6 fëmijë:

Merion, Tomas Edison Xhuniur, Uilliam, Medlin, Çarls dhe Teodor. Ai u përpoq të rrënjoste tek secili prej fëmijëve dashurinë për dijen, edhe pse metodat e tij nuk ishin gjithmonë të këndshme.

Kështu kur e pyeste për detyrat e shtëpisë çdo mëngjes, Edisoni e prekte Medlin me një lugë të nxehtë në dorë, nëse ajo do të përgjigjej shumë ngadalë apo gabim. Por një mjedis i tillë ishte me sa duket shumë toksik për një nga djemtë e tij, Tomas Edison Xhuniur.

Ky e e braktisi shkollën përgatitore që në moshën 17-vjeçare, dhe më vonë u sulmua ngamedia për propagandimin e shpikjeve të dyshimta si "Vitalizer", një kapele, për të cilin ai pretendoi se e bënte të mendohej më shpejt cilindo që e mbante në kokë.

U akuzua për ekzekutimin e një elefanti për qëllime eksperimentale

Në vitet 1890, fuqia elektrike e rrymës direkte (DC) e Edisonit po konkurronte për epërsi me fuqinë e rrymës alternative (AC) të Nikola Teslës. Gjatë kësaj kohe, Edisoni dhe mbështetësit e tij argumentuan se AC ishte e rrezikshme, dhe u përpoqën ta vërtetonin këtë duke goditur kafshët me këtë rrymë.

Sigurisht, edhe rryma direkte DC mund të vriste po aq lehtë. Në vitin 1903, energjia elektrike u përdor për të vranë Topsin, një elefant cirku që ishte dënuar me vdekje, pasi kishte vranë një spektator. Megjithatë Edison akuzohej shpesh për ekzekutimin e kafshës, një artikull i Smithsonian në vitin 2017, pretendon se ai nuk ka pasur dijeni mbi atë ngjarje

"Menlo Park" ishte një vend triumfesh dhe tragjesh

Kur Edison ishte 28 vjeç, ai bleu një fermë në Raritan Township, Nju Xhersi, të cilën e përdori si shtëpi dhe laborator. Pikërisht aty përgjatë një dekade, Edisoni dhe stafi i tij shpikën më shumë se 400 artikuj. Por ai vend ishte edhe vendndodhja e disa tragjesh. Kështu gruaja e parë e Edisonit, Meri, vdiq nga një mbidozë e morfinës në vitin 1884, ndërsa po përpiquej të menaxhonte dhimbjet pas lindjes së fëmijës së tyre të tretë.

Pas asaj ngjarjeje Edison u zhvendos nga atje, duke e shkatërruar shtëpinë dhe objektet përreth. Qyteti u riemërua Edison në vitin 1954. Sot në "Menlo Park" gjendet Qendra Tomas Edison, ku vizitorët mund të shohin disa nga shpikjet e shkencëtarit të madh.

Disa nga vëllezërit e motrat e tij patën një fat të keq

Tomas Edison kishte 6 vëllezër e motra, Merion, Uilliam, Harriet, Karlil, Samuel dhe Eliza.

Kur Edison lindi në Milano të Ohajos në vitin 1847, ai ishte fëmija i shtatë dhe i fundit i prindërve Samuel Edison dhe Nensi Edison.

Fatkeqësisht, Edisoni nuk pati mundësinë të njihet të gjithë vëllezërit e motrat e tij. Nga 7 fëmijët e prindërve të tij vetëm 4 mbijetuan deri në moshë madhore. Karlil, Samuel dhe Eliza, vdiqën që kur ishin fëmijë të vegjël.

Lufta Civile e SHBA-së, nxiti interesin e Edisonit për shpikjet

Kur Tomas ishte 7 vjeç, familja e tij u zhvendos me banim në Port Huron, Miçigan. Edisoni ishte një nxënës i pa interesuar për shkollën, ndaj u arsimua në shtëpi nga nëna e tij. Në moshën 15-vjeçare, ai vendosi të udhëtonte në mbarë SHBA-në, duke dërguar dhe marrë mesazhe përmes telegrafit për trenat dhe Ushtrinë e Unionit gjatë Luftës Civile. Ajo përvojë frymëzoi edhe pasionin e tij të përjetshëm për shpikjet.

Sëmundja ishte çuditërisht një faktor kyç në suksesin e tij

Edison vuajti që nga fëmijëria nga probleme të theksuara me dëgjimin. Askush nuk është saktësisht i sigurt se çfarë i shkaktoi ato. Edhe pse vetë Edison fajësoi një drejtues treni, që në një rast e ngriti në ajër duke e kapur nga veshët, dhe duke i shkaktuar në këtë mënyrë dëme të riparueshme.

Më shumë gjasa, infeksionet e veshit ndikuan në aftësinë e tij për të dëgjuar. Megjithatë Edisoni thoshte se humbja e dëgjimit, i dha aftësinë e tij të jashtëzakonshme për t'u përqendruar shumë në çdo detyrë që kishte në dorë.


Citate të famshme të Tomas Edison:

"Gjeniu është 1 për qind frymëzim, dhe 99 për qind djerse".

"Vlera e një ideje, qëndron tek përdorimi i saj".

"Unë nuk kam dështuar. Sapo kam zbuluar 10.000 mënyra që nuk do të funksionojnë!".

/bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Superliga e basketbollit sjell derbin Rahoveci - Peja

Prishtinë, 25 mars - Në fundjavë do të zhvillohet xhiroja e 24-t në Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll. Ndeshja e parë zhvillohet në mes të Trepçës dhe Dritës. Mitrovicasit janë favoritë, pasi kanë 16 fitore e shtatë humbje, kurse gilanasit janë në vendin e fundit me 23 humbje në 23 ndeshje të zhvilluara, duke qenë skuadra e vetme pa fitore në elitën e basketbollit. Takimi i dytë pritet të jetë më interesant në mes të Rahovecit dhe Pejës, që u përballen edhe në Ligën Unike në mesjavë, ku fitore shënuan "Vreshtarët" me rezultat 86:68. Në elitën e basketbollit, rahovecasit kanë dhjetë fitore e 13 humbje, ndërsa pejanët 15 fitore e tetë humbje. Të dielën do të takohen Golden Eagle Ylli me Prizrenin 16 që, po ashtu, u sfiduan në Ligën Unike në mesjavë, ku fituan therandasit me rezultat 68:95. Skuadra nga Theranda në elitën e basketbollit është lidere me 18 fitore e pesë humbje, kurse prizrenasit kanë 13 fitore e dhjetë humbje. Ndeshja e fundit është ndërmjet Sigal Prishtinës dhe Bashkimit, rivalëve të vjetër në basketbollin e Kosovës. Prishtinasit kanë 11 fitore e 12

humbje, kurse prizrenasit nëntë fitore e 14 humbje, duke synuar zonën e "play-off"-it.

Përballja e finalistëve të Ligës Unike

Xhiroja e fundit apo e 20-ta në Superligën e Femrave do të sjellë derbin në mes të Prishtinës dhe Penzës, dy skuadra që u përballën të enjten në finalen e Ligës Unike te femrat, ku triumfuan vashat prishtinase 66:65. Në elitën e basketbollit vashat prishtinase

SUPERLIGA - Meshkujt

Të shtunën takohen:
17:00 Trepça - Drita
19:00 Rahoveci - Peja

Të dielën takohen:
17:00 Golden Eagle Ylli - Prizreni 16
19:00 Sigal Prishtina - Bashkimi

SUPERLIGA - Femrat

Të shtunën takohen:
19:00 Prishtina - Penza

Të dielën takohen:
12:00 Kastrioti - Vëllaznimi
13:00 Trepça - Bashkimi



kanë 19 fitore në po aq ndeshje të zhvilluara dhe do të mundohen t'i përfundojnë garat e rregullta pa asnjë humbje, kurse skuadra pejane ka 15 fitore e katër humbje. Ndeshja tjetër zhvillohet ndërmjet Trepçës dhe Bashkimit, dy skuadra që, po

ashtu, kanë siguruar një vend në "play-off". Mitrovicasit kanë shtatë fitore e 12 humbje, ndërsa prizrenaset 12 fitore e shtatë humbje. Skuadra mitrovicase do të përfundojë në pozitën e katërt, kurse ajo prizrenase e treta. Edhe pse është xhiroja e fundit, tashmë

janë përcaktuar çiftet gjysmëfinaliste të "play-off"-it: Prishtina - Trepça dhe Penza - Bashkimi. Në këtë xhiro përballen edhe Kastrioti - Vëllaznimi. Skuadra ferizajase ka 19 humbje në 19 ndeshje, ndërsa skuadra kuqezi katër fitore e 15 humbje.

FFK-ja dhe ekipi përfaqësues mbështetin Fondin e Sigurisë me 35 mijë euro



Prishtinë, 25 mars - Federata e Futbollit e Kosovës dhe ekipi përfaqësues kanë ndarë 35 mijë euro për Fondin e Sigurisë, i cili javë më parë është hapur nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Në këtë shifër të ndarë për ushtrinë e vendit, me 50 për qind të mjeteve ka kontribuar FFK-ja dhe anëtarët e KE-së, ndërsa 50 për qind janë grumbulluar nga mjetet vetjake të futbollistëve. "Ne si FFK konsiderojmë se kjo është vetëm një shifër simbolike, por

mjaft domethënëse për forcimin e ushtrisë së vendit tonë, njëherësh është në interes të sigurisë dhe të ardhmes së qytetarëve tanë. Falënderoj lojtarët e ekipit përfaqësues për gatishmërinë e tyre për të përkrahur në vazhdimësi iniciativën e tillë dhe ky veprim i tyre le të shërbejë si motiv edhe për shumë të tjerë për ta mbështetur në të gjitha format forcimin e shtetit tonë", ka thënë Agim Ademi, kryetar i FFK-së.

Mësohen çiftet çerekfinaliste të Ligës Unike

Prishtinë, 25 mars - Në mesjavë është zhvilluar xhiroja e 14-t në Ligën Unike te meshkujt, që ishte e fundit për garat e rregullta, ku është mësuar renditja përfundimtare. Kampioni Golden Eagle Ylli përfundoi garat e rregullta me 13 fitore dhe një humbje, ndërsa Peja ishte

e dyta me nëntë fitore e pesë humbje. Këto dy skuadra janë kualifikuar direkt në gjysmëfinale. Në vendin e tretë është Prizreni 16 me tetë fitore dhe gjashtë humbje, ndërsa Tirana, Teuta dhe Rahoveci kanë shtatë fitore e shtatë humbje, duke përfunduar në vendin e

katërt, të pestë dhe të gjashtë. Në dy pozitën e fundit përfunduan Vllaznia dhe Kamza. Në çerekfinale të Ligës Unike do të përballen Prizreni 16 me Rahovecin dhe Tirana me Teutën. Skuadra e cila nxjerrë rezultat më të mirë nga dy ndeshjet e zhvilluara do të



LIGA UNIKE

jetë gjysmëfinaliste. Ekipet më mirë të renditura luajnë si vendese në ndeshjen e kthimit.

Federeri: Karriera ime nuk është në përfundim

CYRIH, 25 MARS - Roger Federeri nuk heq dorë nga rikthimi në fushë edhe pse ai do të jetë i avashtë dhe pas shumë muajsh pushim. Tenisti zviceran nuk luan që prej grand slam të Wimbledonit të vitit të kaluar dhe pritet që rikthimi në fushë të vijë në fund të

kësaj vere. Gjithsesi, fitues i 20 grand slameve ka shprehur optimizëm për të ardhmen, pavarësisht moshës. "Në mars të vitit të kaluar rikthehesha në fushë pas shumë muajsh pushim, ku luftova me dëmtimet e mia. Ai ishte një moment i rëndësishëm

për mua dhe karrierën time, pasi më motivoi për të ardhmen. Kjo gjë po ndodh edhe tani. Jam i motivuar për t'u rikthyer në fushë, madje për të qenë kompetitiv", ka thënë Federer për mediet zvicerane. "Fansat e mi më mbështetnin kudo dhe kjo është e

rëndësishme për mua. Turnetë ku luajta vjet më bënë të kuptoj se karriera ime nuk është ende drejt fundit. Përparimet që bëj më forcojnë çdo ditë e më shumë dhe e di se një ditë do të jem mjaftueshëm i fortë për të luajtur në nivele të larta", ka deklaruar



Federeri, aktualisht numri 27 në botë.

Mançini: Eliminimi është zhgënjimi më i madh në karrierë

PALERMO, 25 MARS - Italia është mposhtur nga Maqedonia e Veriut (0-1) në "play-off" dhe nuk arriti ta vazhdonte rrugëtimin e tyre për në Botëror. Roberto Mançini pas ndeshjes është shfaqur shumë i tronditur, teksa e quan një nga zhgënjimet më të mëdha në karrierën e tij, ndërsa theksoi se fati ishte kundër kombëtares së tij në këtë Botëror, pasi nuk duhej të ishte fare në fazën "play-off" pasi duhej të ishte kualifikuar që nga grupet. "Nëse fitorja e Evropianit në korrik ishte gëzimi më i madh i imi në aspektin profesional. Ky është zhgënjimi më i madh. Shpesh në futboll ndodhin gjëra të pabesueshme, ndoshta as nuk duhej të ishim në 'play-off'. Sonte bëmë gjithçka që të fitonim, as nuk mund të flitet për ndeshjen. Fitorja e Evropianit ishte super e



merituar, kemi luajtur shumë mirë. Le të themi që fati i cili na ka ndjekur pak në Evropian, u transformua në mungesë të plotë fati në rrugëtimin drejt Botërorit. Kjo skuadër ka lojtarë të mirë. Më vjen shumë keq për të. Në aspektin njerëzor i dua më shumë djemtë sot sesa në korrik. Ky është një moment

vështirësie", ka thënë Mançini. "E ardhmja ime? Do të shohim, është e vështirë të flasësh tani për javët dhe muajt e ardhshëm. Duhet të lejojmë të kalojmë pak kohë, pasi zhgënjimi është shumë i madh. Kjo skuadër, sipas meje, mund të ketë një të ardhme të madhe", ka shtuar Mançini.

Fitojnë Phoenixi dhe Milwaukee, Memphis siguron fazën 'play-off'

TORONTO, 25 MARS - Phoenixi fitoi me rezultatet 140-130 ndaj Denverit në një ndeshje spektakolare, duke u bërë ekipi i parë këtë sezon në NBA që arrin kuotën e 60 fitoreve. Të gjithë titullarët e Phoenixit realizuan mbi 10 pikë, ku lider ishte Kevin Booker, autor i 49 pikëve dhe 10 asistimeve. Ekipi i tretë që kualifikohet në "play-off" është Memphis, që fitoi me rezultat 133-103 ndaj Indianas. Sfidë e dominuar nga vendasit, ku u dallua Bane me 30 pikë, ndërkohë që 63 pikë erdhën nga lojtarët e stolit. Fiton edhe ekipi kampion i



Milwaukeees, që mundi me rezultat 114-102 Washingtonin, në një ndeshje të dominuar nga vendasit. Mungesa e Antetokounmpos nuk u ndje shumë te Bucks, ku shtatë lojtarë realizuan mbi 10 pikë (Holiday 24

pikë më i miri). Në takimet e tjera të luajtura, Toronto fitoi me rezultat 117-104 ndaj Clevelandit (Siakam 35 pikë), ndërsa New Orleansi befasoi Chicagon, duke fituar me rezultat 126-109 (Graham 30 pikë).

REZULTATET

Toronto - Cleveland	117-104
Memphis - Indiana	133-103
Milwaukee - Washington	114-102
New Orleans - Chicago	126-109
Denver - Phoenix	130-140

SHKURT

Bardhi: Emocionuese ndeshja dhe fitorja kundër Italisë

Pas përfundimit të ndeshjes së "play-off"-it në Palermo, ku Maqedonia mundi kombëtaren e Italisë me golin e Trajkovskit në kohën shtesë, Enis Bardhi potencoi se kjo është ndeshja më emocionuese që ka pasur në karrierën e tij. "Është një emocion që nuk mund ta përshkruaj. Jemi shumë të kënaqur. Është edhe një ndeshje, edhe një finale ku do të përballemi me Portugalinë, por ende jemi me atë euforinë e fitores. Çdo ndeshje e tillë ka emocionet e veta. Kjo me Italinë ka qenë ndeshja më me emocionuese që e kam përjetuar prej sa jem pjesë e reprezentacionit të Maqedonisë", ka thënë Bardhi.

Xhaka: Do të jap gjithçka për të fituar ndaj Kosovës

Kosova do të zhvillojë ndeshje miqësore me Zvicrën më 29 mars në Cyrih, në stadiumin e Letzigrund me fillim nga ora 18:00. Kjo ndeshje do të jetë speciale për Xhakën, Shaqirin e Zeqirin që kanë prejardhje nga Kosova. Madje Granit Xhaka do të jetë kapiteni i Zvicrës, kurse ndaj Kosovës do ta luajë ndeshjen e 100 me fanellën e Zvicrës. Ai për gazetën zvicerane "Blick" ka thënë se do të kënaqet me lojën, por deklaroi se do të japë gjithçka për ta fituar atë ndeshje. "Do të kënaqem me lojën, në fakt i njoh të gjithë kundërshtarët. Sigurisht që do të jap gjithçka për të fituar edhe këtë ndeshje", ka thënë Xhaka.

Nëse largohet Mançini, vjen Ancelotti

Nëse Roberto Mançini vendos të largohet nga detyra e trajnerit të Italisë, pasardhës i tij mund të jetë Carlo Ancelotti. Pas humbjes nga Maqedonia e Veriut (0-1), Mançini mund të largohet. "Do ta shohim", ishin fjalët e trajnerit italian.

"Gazeta dello Sport" raporton nëse Mançini largohet, Ancelotti është dëshira e Italisë. Problemi për Italinë është se Real Madridi nuk po e mendon largimin e italianit, i cili ka kontratë me "Mbretërit" deri në vitin 2023, me opsion zgjatje edhe për një vit.

Silva: Dua të luaj si Maldini deri në moshën 40-vjeçare

Thiago Silva dëshiron të ketë një karrierë deri te të 40-at ashtu si legjenda e Milanit, Paolo Maldini. Qendërbrojtësi i Chelseat, 37 vjeç, vazhdon të luajë në nivele shumë të larta edhe pas largimit nga PSG-ja në vitin 2020. Autor i pesë golave në 69 ndeshje me blutë, ai fitoi edhe Ligën e Kampionëve në sezonin e parë në "Stamford Bridge", ndërsa në janar kapiteni i Brazilit rinovoi kontratën deri në vitin 2023. "Unë shpresoj që mund të bëj të njëjtën gjë që Maldini bëri te Milani, duke luajtur deri në moshën 40-41 vjeç. Ky është plani im për të ardhmen e afërt dhe e kam përgatitur veten për këtë. Kur je i ri e mendon veten se je superhero. Sot të duhet ta menaxhosh veten", ka thënë Silva.


Barça sfidon Realin për Mbappen

Afati kalimtar i verës është afër dhe thashethemet e transferimeve sa vijnë e shtohen më shumë. Emri më i nxehtë këtë afat kalimtar është Halaand dhe Mbappe. Ky i fundit do të jetë një lojtar i lirë në fund të

sezonit nëse nuk rinovon kontratën, dhe i pari që e pret me krahë hapur është "Los Blancos". Verën e kaluar PSG-ja pati shansin më të mirë për ta shitur, pasi Real Madridi i ofroi në ditët e fundit të merkatos klubit

francez rreth 200 milionë euro për Kylian. Por tashmë Reali ka shansin të nënshkruajë falas me të, e për këtë gjë thuhet se do të ketë një problem. Gazeta e famshme franceze, "L'Equipe", thotë se Barcelona ka

menduar t'i bëjë konkurrencë rivalëve të tyre spanjollë. Real Madridi nuk ndien presion për këtë gjë, pasi është i bindur se nëse Mbappe largohet nga PSG-ja, Madridi do të jetë destinacioni i tij i radhës.



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Albrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek "REB BULLI", në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:
044-514-373 dhe 044-199-707.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Intelligent Software Technologies "ISoft Technologies" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70376410.
- ▶ Benjamin Arifi B.I shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 810026163
- ▶ Ylber Haxhija nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. II dhe Diplomën e sh.m. t "Nexhmedin Nixha".
- ▶ Blenda Kransiqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. së dhjetë të Gjimnazit "Sami Frashëri" Prishtinë.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur me të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

- Quality & Sales Award Recipients**
(Listed in alphabetical order)
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
 - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
 - ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
 - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
 - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
 - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
 - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
 - ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
 - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
 - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

